



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti

ZYRA PËR INFORMIM PUBLIK

NJOFTIM PUBLIK LIDHUR ME MBLEDHJEN E -VII- TË RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË VITISË

Njoftohen qytetarët e Komunës së Vitisë se mbledhja e -VII- rregullt e Kuvendit Komunal të Vitisë, do të mbahet me datë 28.10.2020, (e mërkurë), duke filluar në ora 10:00. Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit, në Shtëpinë e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Kjo mbledhje është e hapur për publikun. Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Kuvendi Komunal.
2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar- shtator 2020.
3. Informatë lidhur me Raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me 31.12.2019
4. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga zyra Kombëtare e Auditimit për Vitin 2019
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të propozim rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.
6. Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të ankandit publik për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.
7. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të Pronës Komunale NPSH "ARENA SPORT" në Kabash
8. a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit nder komunal e kryetarit të komunës së Vitisë me Komunat e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.
- b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të komunës së Vitisë me Komunat e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.
- c) Propozim vendimin për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunat e Republikës së Kosovës në fushat e përgjithshme si infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi etj.
9. Informatë për raportin e performances për vitin 2019 të Komunës së Vitisë

Plotësim: Me qëllim që qytetarët të njihen rreth këtyre propozim dokumenteve, ZIMP në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal ka publikuar ato në ueb faqen zyrtare kk.rks-gov.net/viti tek rubrika draft dokumentet e Kuvendit Komunal.

Viti, 21.10.2020

Zyra për Informim Publik